



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 20.02.2025

Nr: 127

Ora: 12: 00

VENDIM

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË DENONCIMIN  
NR. 33 ID, DATË 18.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE, TË PARTISË  
DEMOKRATIKE/PD**

Sot më datë 20.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

**KËRKUES:** Partia Demokratike

**SUBJEKT:** **Z. Engjëll Agaçi**  
Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave

**OBJEKT:** Konstatim i kryerjes së veprimtarive të ndaluara bazuar në nenin 91/4 të Kodit Zgjedhor, konkretisht miratimi i akteve nënligjore dhe propozimi për dhënien e ndihmave për një kategori të caktuar, para periudhës zgjedhore.

**BAZA LIGJORE:** Neni 91, pikat 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator.

**KONSTATOJ:**

Partia Demokratike më datë 18.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 33 ID.

Në këtë denoncim Partia Demokratike parashtron sa vijon:

*“Rezulton se në fletoren zyrtare nr.19, datë 03.02.2025 është publikuar Udhëzim i përbashkët i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe i ministrit të Financave nr. 549/1, datë 20.12.2024 “Për procedurën e pagimit të tarifës së licencës së prodhimit të Cannabis-it për qëllime mjekësore dhe mënyrën e përdorimit të kësaj tarife”.*

Data: 20.02.2025

Nr: 127  
Ora: 12:00



“Për fillimin e procedurës administrative bazuar në denoncimin nr. 33 ID, datë 18.02.2025, të regjistrin të denoncimeve, të Partisë Demokratike/PD”

*Në fletoren zyrtare nr.5 datë 13.01.2025 është publikuar Vendim i Këshillit të Ministrave nr.9 datë 9.01.2025 “Për përcaktimin e rregullave dhe të tarifave për ruajtjen dhe sigurinë fizike për subjektet e lejuara”.*

*Në fletoren zyrtare nr.13 datë 23.01.2025 është publikuar Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 50, datë 22.1.2025 “Për miratimin e standardeve për zonat dhe parcelat e tokës, në të cilat do të lejohet kultivimi i bimës së cannabis-it për qëllime mjekësore dhe industriale”.*

*Këto akte janë nxjerrë në shkëlqje të ndalimeve të parashikuara nga neni 91/4 i Kodit Zgjedhor, pasi parashikojnë dhënien e përfitimeve për një kategori të caktuar subjektësh të cilat do të aplikojnë për t’u pajisur me licencë për përpunimin e bimës së cannabis-it dhe nënprodukteve të tij”.*

Nga sa më sipër çmohet, ekzistojnë kushtet për t’u nisur hetimi administrativ.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

### **V E N D O S:**

1. Fillimin e procedurës administrative ndaj:
  - Z. Engjëll Agaçi, Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**